




Alberta Prodan

A



R. Prodan

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2718/18 Prot.

Vlorë më, 21. 11. 2024

VENDIM

Nr. 78 datë 20.11.2024

PËR

HAPJEN E PROGRAMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR NË "TEKNIK LABORATORI", NË FAKULTETIN E SHËNDETIT, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026 NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË

Në mbështetje të nenit 25, pika 7, 38, pika 1, shkronja dh, nenit 71, 73, të ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 10, pika 6, nenit 19, pika 1, shkronja ë, të Statutit të Universitetit "Ismaël Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1 të MAS datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve", VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", e ndryshuarr, si dhe referuar propozimit të Departamentit të Kujdesit Shëndetësor, si dhe relacionit të Zëvendësrektorit Akademik, përcjellë me shkresën 2651, prot, datë, 19.11.2024, Senati Akademik në mbledhjen e datës 20.11.2024,

VENDOSI

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Kujdesit Shëndetësor, në Fakultetin e Shëndetit, për hapjen e programit të studimit Bachelor në "Teknik Laboratori", sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektorit Akademik, Drejtuesit e Fakultetit të Shëndetit, si dhe Drejtoria e Ciklit të Parë dhe të Dytë të Studimit.
3. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj

A. Saliaj

